

## REKOMANDIME

### Konventa Kombëtare për Integrimin European 2021-2023

#### Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

#### Sesioni 4: Sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale

28 shkurt 2023, 11:00 – 13:00

Më 28 shkurt 2023, Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit) organizoi në kuadër të Konventës sesionin e radhës me fokus të sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale (IA). Përdorimi i IA në këtë fushë ka shumë ndikime pozitive për konsumatorët, por shoqërohet gjithashtu me disa efekte negative si pabarazia, manipulimi, keqpërdorimi i të dhënave, diskriminimi i konsumatorit etj. Përgjatë sesionit 4 të GP III, u evidentuan këto dhe problematika të tjera lidhur me përdorimin e IA dhe u formuluan disa rekomandime për të siguruar mbrojtje për konsumatorët në tregun shqiptar me standardet më të larta.

## REKOMANDIME

- Legjislacioni duhet ndërtuar në mënyrë të tillë për të mbrojtur konsumatorin, por duhet treguar kujdes me mbi-rregullimin e situatave (ngurtësinë ligjore) pasi mund të kufizohen përfitimet e konsumatorit nga IA dhe zhvillimi i kësaj fushe.
- Edhe pse nuk ka ende rregullime ligjore specifike për inteligjencën artificiale, situatat lidhur me to mund të gjejnë rregullim në ligje të tjera si lidhur me sigurinë e produkteve, praktikën e padrejta tregtare, tregtinë online (e-commerce). Megjithatë, politika mbrojtëse specifike për konsumatorët lidhur me përdorimin e IA duhet të hartohen dhe miratohen sa më shpejt.
- Hapi i parë për të garantuar mbrojtjen e konsumatorit ndaj efekteve negative të IA, është evidentimi i rreziqeve për konsumatorin dhe më pas marrja e masave për ndalimin e tyre. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar grupeve vulnerable, me masa mbrojtëse ndaj manipulimit apo shfrytëzimit të tyre.
- Duhet specifikuar të drejtat e konsumatorit në lidhje me IA në rastet kur nuk është e qartë ose të plotësohen boshllëqet legjislative (të vlerësohet legjislacioni aktual), duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe privatësisë së konsumatorit kur përdoren këto teknologji.
- Legjislacioni dhe parimet europiane që sigurojnë standardet më të larta për mbrojtjen e

*konsumatorit, duhen zbatuar në rendin e brendshëm ligjor, duke nisur nga dispozitat e Kodit Civil për të mbrojtur pozicionin e konsumatorit.*

- Veç legjislacionit aktual të BE-së, duhet konsideruar edhe 'Akhenda e Re për Konsumatorin' që përfshin transformimin e gjelbër dhe dixhital. Në dritë të këtij të fundit është edhe propozimi për Rregulloren për Inteligjencën Artificiale, ku bëhet ndarja e rreziqeve ndaj IA në katër kategori, të cilat duhen marrë për bazë.*
- Transparenca është parimi më i rëndësishëm që duhet të gjejë zbatim kur bëhet fjalë për përdorimin e inteligjencës artificiale, e cila duhet t'i njoftohet konsumatorit në çdo rast. Në rastet kur operatorët përdorin IA të kategorizuara me 'rreziqshmëri të lartë', kjo për shkak të ndikimit që mund të kenë për konsumatorët dhe të drejtat e tyre, duhet të sigurohen monitorues që bëjnë vlerësimin e riskut dhe gjurmueshmërinë e veprimeve për llogaridhënie.*
- Llogaridhënia dhe mbajtja e përgjegjësisë në raste kur përdoret intelijenca artificiale janë sfiduese dhe të komplikuar dhe BE është në hapat e parë të konsolidimit dhe njësimimit të praktikave ligjore e gjyqësore në shtetet anëtare me anë të një Direktive të Re. Do të ishte me shumë vlerë që një shtet në proces integrimi si Shqipëria gjithashtu t'i ndiqte këto zhvillime.*
- Tepër e rëndësishme për sa më sipër është edhe ndërgjegjësimi i publikut, informimi jo vetëm mbi përfitimet, por edhe rreziqet që IA paraqet për ta, mënyrat se si mund të mbrohen dhe institucionet përgjegjëse ku mund të drejtohen.*
- Përdorimi i inteligjencës artificiale është në rritje dhe i prek shumë konsumatorët, megjithatë rregullimet ligjore janë ende në zhvillim dhe jo fort të konsoliduara. Krijimi i një grupi pune ndër-sektorial për të ndjekur me hap të njëjtë zhvillimet e fundit dhe të mbikëqyrin zbatueshmërinë në praktikë do të ishte me shumë vlerë.*